



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 88, DATË 08.10.2020

PËR

RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “GOOD NEWS J-MEDIA” SH.P.K.,
PËR SUBJEKTIN AUDIO PRIVAT “RADIO 7 NORD”

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, germa b dhe nenit 55, pika 1, germa c të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe rregullores “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së transmetimit audio”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 153, datë 18.07.2016, të ndryshuar, si dhe pas shqyrtimit të aplikimit nr. 3942 prot., datë 01.11.2019, të shoqërisë “Good News J-Media” sh.p.k., për rinovimin e licencës së subjektit audio privat “Radio 7 Nord”, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës së shoqërisë “Good News J-Media” sh.p.k., me NIPT: L11628011D, administrator zj. Jonida Viso, për subjektin audio privat “Radio 7 Nord”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
2. Saktësimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit nga “*Bashkitë Shkodër dhe Vau i Dejës*” në “*Bashkitë Shkodër, Vau i Dejës dhe Njësinë Administrative Koplík*”.
3. Ndryshimin e kushteve teknike të licencës së subjektit, sipas karakteristikave teknike të Aneksit nr. 1, bashkëlidhur.
4. Kushtet e licencës së shoqërisë “Good News J-Media” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio 7 Nord”, përveç zonës së ofrimit të shërbimit, mbeten të pandryshuara.
5. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim, për pikën 1, i shtrin efektet duke filluar nga data 31.12.2019, ndërsa për pikat 2 dhe 3 hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Gentian	SALA
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ
Anëtarë:	Agron	GJEKMARKAJ
	Gledis	GJIPALI
	Suela	MUSTA

ANEKSI NR. 1

Karakteristikat teknike të transmetimit:

Pika e transmetimit	Frekuenca MHZ	Koordinatat XYZ	Fuqia Nominale (W)	Amplifikimi (dBi)	ERP (W)	Azimuth (°)	Lartësia e antenës (m)	Drejtimi i antenës
Tarabosh	97.5	19.27014 42.02490 580 4DMS	200	6	485.5	90	20	D